



AVOKATI I POPULLIT

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës,  
trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok. 202300355/2

Tiranë \_\_\_/\_\_\_/2023

**Lënda :** *Rekomandime mbi inspektimin e kryer në Komisaratin e Policisë Dibër.*

**Drejtuar:** Drejtues i parë z. Dhimitraq ZIU  
Drejtor i Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër

**PESHKOPI**

Kryekomisar z. Alfred HOXHA  
Shef i Komanduar i Komisarimit të Policisë Dibër

**PESHKOPI**

**Për dijeni:** Drejtues Madhor z. Muhamet RRUMBULLAKU  
Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit

**TIRANË**

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruës (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 "Për Avokatin e Popullit", i ndryshuar, nenin 81 të ligjit nr.81/2020 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të parburgosurve", kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatit të Policisë në Dibër.

Inspektimi u krye në datën 13.04.2023, sipas Planit të Inspektimit të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

MKPT, bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të emigrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria, azilkërkuesit, institucionet psikiatrike dhe shtëpitë e të moshuarve.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014 "Për Policinë e Shtetit", i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde të punës “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit të MKPT-së, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e DVP Dibër z. Dhimitraq Ziu dhe me shefin e komisariatit z. Alfred Hoxha të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e vizitës së inspektimit të MKPT-së në mjediset ku mbahen personat e privuar nga liria në DVP Dibër.

Në takim, grupi i inspektimit të MKPT-së u informua mbi masat e marra nga strukturat përgjegjëse në DVP Dibër për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm dhe për ndërtimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, si dhe për krijimin e dhomave të sigurisë në këtë institucion, sipas standardeve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare për persona të ndaluar/arrestuar.

Në vijim të këtij informacioni, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit inspektuan nga afër punimet e ndërtimit të godinës së re me 3 kate të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Punimet në godinë kanë përfunduar dhe godina është në fazën e mobilimit të ambienteve të zyrave të administratës së institucionit, të zyrave të pritjes së qytetarëve, dhomat e mjekut, dhoma për marrjen në pyetje të të ndaluarve/arrestuarve nga prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore dhe dhomat e arrestimit/ndalimit. Ndërkohë, u konstatua se ishin në proces të vendosjes së shtretërve në dhomat e sigurisë, ku ishin ndërtuar 7 dhoma sigurie, nga të cilat 5 dhoma për të rritur, 1 dhomë për gra dhe 1 dhomë për të mitur në konflikt me ligjin. Kapaciteti i ambienteve ishte për 14 persona të ndaluar/të arrestuar, të ndarë sipas dhomave. Dhomat e sigurisë ishin ndërtuar sipas standardeve dhe përcaktimeve të bëra në aktet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe në aktet ndërkombëtare. Struktura ishte ndërtuar **sipas kërkesave të ligjit** nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe aktit të procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrit nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

Gjithashtu, bazuar në projektin e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në favor të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, punimet ishin në proces e sipër, nisur prej vitit 2021 dhe është parashikuar të përfundojnë për një periudhë prej 24 muajsh, ku godina mendohet të jetë funksionale në tetor të vitit 2023. Vlera e ndërtimit të godinës është në shumën 348.860.996 lekë.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson pozitivisht faktin e përfundimit të punimeve dhe fillimin e punimeve për instalimin e sistemit ngrohje/ftohje, të vendosjes së sistemit

të monitorimit të kamerave, të shtretëve dhe pajisjeve të tjera sipas fazës së zbatimit të projektit për ndërtimin e godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, duke i inkurajuar për përfundimin e punimeve sa më shpejt në këtë institucion, por duke patur në vëmendje se ajo do të garantojë kushtet, liritë dhe të drejtat e personave gjatë ndalimit/arrestimit në mjediset policore ose në vende të tjera, sipas kushteve dhe rasteve të përcaktuara në ligj. Nga ana tjetër, Avokati i Popullit kërkon që ndërtimi i institucionit të jetë në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, për të respektuar procedurat e shoqërimit të personave në konflikt me ligjin, sipas aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve dhe të ndihmës specialistëve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona. Gjatë ushtrimit të detyrës për inspektimin e ambienteve ku mbahen dhe trajtohen personat e privuar nga liria, grupi inspektues ishte i shoqëruar nga shefi i rendit të Komisarariatit të Policisë Dibër dhe punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente.

Në vijim të inspektimit, u konstatua se dhomat e sigurisë ekzistuese në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, nuk respektonin standardin e kubaturës dhe sipërfaqes jetike për person të përcaktuar në aktet normative. Ndërkohë që mungesa e shtretëve dhe pajisjeve të tjera përbëjnë një trajtim çnjerëzor dhe denigruës për persona të ndaluar/arrestuar, që qëndrojnë në këto ambiente të privimit të lirisë.

Grupi i inspektimit evidentoi gjithashtu se nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në gjendjen që ndodhen dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, rezultoi se:

1. **Ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një regjistri të veçantë për evidentimin e të dhënave të të miturve të shoqëruar në mjediset e komisarariatit<sup>1</sup>.

**Gjithashtu, u evidentua se nuk ishin zbatuar rekomandimet në lidhje me:**

2. Nuk kishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin e dhomave të sigurisë me shtretër për fjetjen e personave të arrestuar/ndaluar, sipas kapacitetit fizik të dhomave.
3. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, për marjen e masave për përshtatjen e ambientit, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të ndara me vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin.

---

<sup>1</sup> Kthim pergjigje të shkresës tonë me numër 52 prot, datë 10.01.2023 të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.

4. Nuk ishte zbatuar rekomandimi, për zëvendësimin e menjëhershëm të materialeve të fjetjes të vjetëruara si dyshekë, batanije, jastëkë, me materiale të reja.
5. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen me telefon fiks, për punonjësit e policisë, i cili të shërbente për njoftimin e zyrës së informacionit në rastet emergjente dhe pajisjen me buton zile/sinjali të montuar në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë.
6. Nuk kishte zbatuar rekomandimi, për lyrjen me bojë dhe dezinfektimin e pjesshëm të mureve të brendshme, të dhomave që ndodhen në ambientin e sigurisë.
7. Nuk kishte zbatuar rekomandimi, për plotësimin e organikës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmësmjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar.
8. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës (zyrës) për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, të arrestuar në flagrancë apo të dyshuar për vepra penale, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë, të cilat duhet të jenë të pajisura dhe me sistemin e monitorimit me kamerave audio-video.
9. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi, për krijimin e** ambientit të hapur të ajrimit për personat e arrestuar/ndaluar, në godinën e re të sigurisë të DVP Dibër, por dhe në Komisariatin e Policisë Dibër, sipas parashikimeve në procedurën standarde për këtë qëllim.
10. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e sigurisë, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Në lidhje me rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuesit e institucionit na informuan se ata ndodhen në këto kushte, duke qenë se së shpejti do të jetë në funksion godina e re e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër sipas akteve ligjore në fuqi. Gjithshtu, na informuan se ka patur komunikim të vazhdueshëm me shoqërinë zbatuese të ndërtimit të godinës dhe sipas tyre brenda muajit qershor të vitit 2023 mund të jetë funksionale sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar; Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

#### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatin e Policisë Dibër, nuk kishte ambiente të dhomave të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde

*“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë, ku garantohet siguria dhe trajtimi njerëzor i tyre, ndërkohë në aktet e lartpërmendura në lidhje me kushtet e mbajtjes dhe sigurinë e personave të shoqëruar, theksohet se *“Mjedisi/ambienti duhet të jetë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim.....si dhe dhoma të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit”*<sup>2</sup>.

Për personat e shoqëruar në konflikt me ligjin përdorej ambienti i pritjes në hyrje të këtij komisariati ose personat qëndronin në një ambient të hapur me stola në oborrin e jashtëm të institucionit, në mungesë të dhomave të përshtatshme.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për personat në konflikt me ligjin, siç është parashikuar në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në polici”*, miratuar me Urdhrin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, tregon mos garantimin e lirive të të drejtave të njeriut, sipas standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimit, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar, dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet këtyre personave nga ana e punonjësve të policisë. Ndërkohë nga regjistri i të shoqëruarve, për periudhën Janar – Prill 2023, rezultoi se ishin shoqëruar për në mjediset e komisariatit 65 persona, nga të cilët 1 person i mitur në konflikt me ligjin. Sipas verifikimit të regjistrimit të shoqërimit nuk kishte të shoqëruara gra për vitin 2023 në institucionin e privimit të lirisë.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i të shoqëruarve, vazhdonte të kryhej në zyrat e punonjësve të policisë, në mungesë të një dhome të veçantë që të jetë e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive, e cila do të parandalonte kryerjen e veprimeve të kundraligjshme me të shoqëruarit, si dhe të çdo kundërveprimi të këtyre personave ndaj punonjësve të policisë.

Gjatë inspektimit, në ambientet e komisariatit, nuk u konstatuan sende dhe mjete të tilla që mund të shërbenin për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Gjithashtu, u evidentua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109, paragrafi 5<sup>3</sup> dhe nenin 122, paragrafi 5<sup>4</sup> të ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4<sup>5</sup> të procedurave standarde për

<sup>2</sup> Kreu VI, pika 3 të procedurës standarde *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*.

<sup>3</sup> Neni 129, paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”*, i ndryshuar parashikon se: *“Punonjësi i policisë, dokumenton në procesverbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.”*

<sup>4</sup> Neni 122, paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 *“Për Policinë e Shtetit”* i ndryshuar parashikon se: *“Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbali nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij”*.

<sup>5</sup>Urdhër nr. 938, datë 24.07.2019 procedura standarde e punës për *“Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”*: Procesverbali i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4

plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisariatin e Policisë Dibër mbaheshin procesverbalet përkatëse, ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Ambienti i sigurisë në Komisariatin e Policisë Dibër, **nuk** ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në procedurën standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 dhe kushtet në të cilat ndodhet ky ambient, bien në kundërshtim të hapur me standardet e përcaktuara në “*Konventën europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese*”<sup>6</sup>.

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit, ku ndodheshin 3 dhoma sigurie, të cilat ishin funksionale, por ato ishin jashtë kushteve teknike dhe kritereve për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar.

Dhomat e sigurisë ishin të ndara në 2 dhoma për personat e arrestuar/ndaluar të rritur dhe 1 dhomë për të miturit. Kapaciteti fizik ishte për mbajtjen dhe sigurimin e 6 personave të arrestuar/ndaluar. Përmasat e dhomave ishin 3x2m dhe nuk plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësore, të hapësirës dhe sipërfaqes për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra<sup>2</sup> dhe nuk ishte e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup><sup>7</sup>.

Gjithashtu, DVP-Dibër kishte një dhomë të sigurisë që ndodhej në Spitalin Rajonal Dibër, e cila shërbente për mbajtjen dhe akomodimin e të ndaluar/arrestuarave femra. Ajo ishte me hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme për jetesë normale me përmasa 4x4 m<sup>2</sup> dhe kishte kapacitet për 1 (një) person.

Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe **nuk** mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ndërsa ndriçimi artificial sigurohej nga rrjeti elektrik dhe një gjenerator për rastet kur kishte ndërprerje të energjisë elektrike.

Dhomat e sigurisë **nuk** ishin të plotësuara me shtretër për fjetjen e personave të ndaluar/arrestuar, ndaj në këto kushte këta persona flinin me dyshekë që vendoseshin në dyshtemenë prej dërrase. Dhomat ishin të pajisura me materialet e fjetjes, si dyshekë e batanije, por ato ishin të vjetëruara dhe të dëmtuara.

Në ambientin e sigurisë, lagështira vazhdonte të ishte prezente kudo dhe muret e brendshme të dhomave ishin të amortizuara. Në rastet kur binte shi, tavani i dhomave

---

“Procesverbali hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimit personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.”

<sup>6</sup> <https://rm.coe.int/16806dbac6>

<sup>7</sup> *Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde “Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

pikonte dhe kishte krijuar shenja myku në mure, duke e bërë të pamundur qëndrimin dhe trajtimin dinjitoz të personave të arrestuar/ndaluar, që sigurohen në këto dhoma.

Në korridorin e ambientit të sigurisë, ndodhej një ambient i përbashkët që shërbente si tualet dhe për larjen e trupit. Ambienti ishte i plotësuar me nyje hidrosanitare, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë).

Ambienti i sigurisë **nuk** kishte të instaluar sistemin ngrohje/ftohje me kaldajë qendrore, sikurse parashikohet në pikën 3/c, Kreu VIII të procedurës standarde. Për shkak të kushteve të rënduara atmosferike në periudhën e dimrit në këtë zonë, ngrohja sigurohej me pajisje elektrike të siguruar nga vetë institucioni, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në korridorin e ambientit të sigurisë **nuk** kishte aparat telefonik fiks apo citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Po ashtu, në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile për njoftimin e personelit të shërbimit, në rastet e nevojave nga personat e ndaluar/arrestuar.

Në ambientin e sigurisë kishte një dhomë të përbashkët që përdorej si zyrë pune nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, por edhe si dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët mbrojtës dhe marrjen e tyre në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur, por **nuk** ishte e monitoruar me sistemin e kamerave. Nisur nga funksioni që kanë këto ambiente, ato duhet të jenë të ndara secila dhomë më vete dhe duhet të jenë të monitoruara me kamera.

Ndërkohë, hyrjet në dhomat e sigurisë dhe korridori i dhomave të sigurisë monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

Në ambientin e sigurisë ndodhej edhe dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, por dhe ajo **nuk** përmbushte standardet e parashikuara, pasi ishte e pa ndriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

**Ndërkohë, nuk kishte hapësira për ajrimin e personave gjatë qëndrimit në dhomat e sigurisë.**

Për marrjen në pyetje të të miturve ishte krijuar “Njësia për intervistimin e të miturve”, në kuadër të projektit 2019-2021 të financuar nga DPPSH, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe UNICEF për ndërtimin e këtyre ambienteve në disa nga Drejtoritë/Komisariatet e Policisë së Shtetit. Ky ambient përbëhej nga 3 dhoma të pajisura me mjetet dhe orenditë e punës për specialistët e policisë të trajnuar për këtë qëllim, për psikologun, si dhe për qëndrimin ulur dhe komod të fëmijës dhe të prindit (kujdestarit ligjor), sikurse përcaktohet në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit dhe në procedurën standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar”. Pamjet filmike të kamerave që monitorojnë ambientin ku merren në pyetje të miturit, ruhen deri në 30 ditë në një server që administrohej nga DVP Dibër.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodhej një person i ndaluar/arrestuar, i cili sapo ishte vendosur në dhomat e sigurisë. Për periudhën e inspektimit Janar – Prill 2023 në dhomat e sigurisë së këtij komisariati, janë trajtuar dhe siguruar 37 persona të

arrestuar/ndaluar dhe asnjë prej tyre nuk ishte femër dhe i mitur. Sipas shënimeve në regjistër, nuk rezultoi të kishte mbipopullime në dhomat e sigurisë, në asnjë periudhë kohore.

**Nga informacioni i drejtuesve të komisariatit dhe punonjësve të policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë, personat e ndaluar/arrestuar trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin Nr.189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi gatuhej në mensën që ndodhej brenda territorit të komisariatit dhe shërbehej sipas vakteve nga kuzhinerët dhe punonjësit e policisë.**

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i përgjegjësit të dhomave të sigurisë, personave të ndaluar/arrestuar u jepen produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjentë, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës inspektuese nuk rezultoi ndonjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të armëve të zjarrit nga ana e policisë, ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur vëren se kushtet në të cilat ndodhen dhomat e mbetura hapur në Komisaratin e Policisë Dibër, nuk plotësojnë kushtet për të konsideruar mbajtjen e të burgosurve në to dhe konsiderohet si një trajtim degradues. Gjithashtu, mbajtja e një numri dhomash nuk e ka përmirësuar gjendjen në të cilën trajtohen të arrestuarit në këtë komisariat.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në Komisaratin e Policisë Dibër “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019. Regjistri ishte i plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë, në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarati evidentoheshin në “Regjistrin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar”, i cili ishte i sekretuar. Edhe ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë së komisariatit.

Nga këqyrja e këtyre regjistrave rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e momentit të



shoqërimin të tyre për në mjediset e policisë. Kjo situatë, u verifikua edhe për personat e ndaluar apo të arrestuar nga Komisariati i Policisë së Bulqizës, të cilët në përfundim të procedurave ligjore të kryera nga specialistët e krimeve, dërgoheshin në dhomat e sigurisë së Komisarariatit të Policisë Dibër.

Avokati i Popullit ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vendoset ora e futjes në mbikqyrje policore dhe jo ora e shoqërimin të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Përsa më sipër, bazuar në aktet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, nëse një person arrestohet në flagrancë apo ndalohet, në procesverbalin përkatës të arrestimit/ndalimit duhet të vihet çasti (ora e kapjes së tij në fakt), kur ai është privuar realisht nga liria. Pra, sapo ai kapet dhe prangoset nga punonjësi i policisë që ka bërë kapjen në flagrancë apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrin të ndalimit. Duke iu referuar neneve 144, 250 të Kodit të Procedurës Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose i ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të Kodit të Procedurës Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe nenin 109, pika 4 të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Nga inspektimi u evidentua se, komisarati kishte regjistër të veçantë për të miturit të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar në konflikt me ligjin, ku evidentohen të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në dhomat e sigurisë të komisarariatit kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në Komisariatin e Policisë Dibër u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin mbrojtës dhe prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimin të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, si dhe regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisariatin e Policisë në Dibër, punonjësit e policisë gjyqësore i kryenin intervistat dhe marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës së ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë, si dhomë për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, shërbente zyra e përgjegjës të dhomave të sigurisë, pra nuk ishte një ambient më vete. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, duke përbërë një standard tjetër të munguar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit<sup>8</sup>.

**Gjithashtu në ambientet e godinës të komisariatit ishte krijuar një ambient i veçantë (magazinë) për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, në interes të hetimit që zhvillonte organi i prokurorisë.**

Në mungesë të intervistave me personat e shoqëruar, nga informacioni i punonjësve të policisë së komisariatit, grupi i inspektimit evidentoi se personave të shoqëruar ju jepej karta e të drejtave që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

Sipas informacionit, u evidentua se zbatohet detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor, që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, atyre ju ofrohet dhe ndihmë juridike duke siguruar një avokat kryesisht, dhe mundësinë për të kontaktuar me të.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të dhomave të sigurisë. Për shtetasit e ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht, kujdestarit ligjor dhe të psikologut. Psikologu ishte në organikë të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe në raste të veçanta asistoheshin dhe nga psikologët që siguroheshin nga Bashkia Dibër dhe Shkolla e Mesme e qytetit Peshkopi.

Në Komisaratin e Policisë Dibër nuk kishte asnjë zyrë të monitoruar me kamera për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën që përdorej për shoqërim në këtë komisariat ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

---

<sup>8</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu, kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë e bërë nga i ndaluarit gjatë intervistës, si dhe nga personat e pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurave Standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme, ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridoret e godinës së këtij komisariati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar, por ato duhen të vendosen dhe brenda në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe në vende që të jenë të aksesueshme nga të ndaluarit dhe të shoqëruarit në mjediset e policisë. Gjithashtu, **për shtetasit e ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndaluarve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.**

Grupi i inspektimit konstatoi se, vizitat mjekësore në mungesë të mjekut në organikë të DVP Dibër, kryheshin nga mjekët e Spitalit Rajonal Dibër brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”<sup>9</sup>.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu, për secilin person hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Mungesa e mjekut apo ndihmës mjekut me kohë të plotë në bazë të strukturës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, çënon standardin për trajtim mjekësor me dinjitet të personave të arrestuar/ndaluar, për kohën që qëndrojnë në dhomat e sigurisë së Drejtorisë/Komisariateve në varësi të saj. Të dhënat e paraqitura më lart, nuk u verifikuan nga persona të ndaluar apo të shoqëruar, pasi nuk kishte persona në këtë cilësi në Komisarlatin e Policisë Dibër.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike*”; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, ku thuhet se: “*Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të*

---

<sup>9</sup> *Kreu V, pika 7.2 të procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”.*

tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”:

### **REKOMANDOJMË:**

1. Marrjen e masave të menjëhershme, për të përfunduar sa më parë ndërtimin e godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe Komisarariatit të Policisë Dibër (Kontratë e cila sipas afateve kohore duhet të përfundojë punimet për një periudhë 24 mujore). Avokati i Popullit rekomandon se duhet të sigurohet që projekti i ri, në përfundim do të garantojë tërësisht kërkesat e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

### **Deri në përfundimin e punime dhe vënien në funksion të godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër rekomandojmë:**

1. **Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e dhomave të sigurisë me shtretër për fjetjen e personave të arrestuar/ndaluar, sipas kapacitetit fizik të dhomave.**
2. Marrjen e masave menjëhershme, për përshtatjen e një ambienti, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të ndara me vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin.
3. Marrjen e masave të nevojshme, për pajisjen me telefon fiks, për punonjësit e policisë, i cili të shërbente për njoftimin e zyrës së informacionit në rastet emergjente dhe pajisjen me buton zile/sinjali të montuar në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevoje.
4. **Marrjen e masave, për zëvendësimin e menjëhershëm të materialeve të fjetjes të vjetëruara si dyshekë, batanije, jastëkë, me materiale të reja.**
5. **Marrjen e masave të nevojshme, për lyrjen me bojë dhe dezinfektimin e pjesshëm të mureve të brendshme, të dhomave që ndodhen në ambientin e sigurisë.**
6. **Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e organikës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmës mjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar.**

7. Marrjen e masave të menjëhershme, për krijimin e dhomës (zyrës) për marrjen në pyetje personat e ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, të arrestuar në flagrancë apo të dyshuar për vepra penale, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë, e cila të jetë e pajisur dhe me sistemin e monitorimit me kamerave audio-video.
8. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti të hapur të ajrimit për personat e arrestuar/të ndaluar, në godinën e re të sigurisë të DVP Dibër, por dhe në Komisarlatin e Policisë Dibër, sipas parashikimeve në procedurën standarde për këtë qëllim.
9. Marrjen e masave të menjëhershme, për vendosjen e orës së mbikëqyrjes policore në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, për personat e shoqëruar në organet e policisë dhe jo orën e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo orën kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.
10. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për analizimin e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kompetencë të këtij institucioni, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive për dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**

*Të nderuar,*

Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, trajtimit ose dënimit të egër, çnjerëzor ose poshtëruar (MKPT), në vijim Mekanizmi Kombëtar, seksion pranë Avokatit të Popullit, bazuar në nenin 19/1 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, nenin 81 të ligjit nr.81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, kreu një inspektim në ambientet e privimit të lirisë së personit në Drejtorinë/Komisariatin e Policisë Dibër.

Inspektimi u krye në datën 13.04.2023, sipas Planit të Inspektimi të miratuar nga Avokati i Popullit. Grupi i inspektimit përbëhej nga z. Hazbi Selita dhe z. Besnik Deda, me detyrë nd/komisionerë pranë Mekanizmit Kombëtar.

MKPT, bazuar në legjislacionin vendas dhe atë ndërkombëtar, mund të vizitojë në çdo kohë dhe pa paralajmërim, të gjitha vendet ku mbahen personat e privuar nga liria, përfshirë organet e policisë në nivel vendor, burgjet, qendrat e pritjes provizore të emigrantëve të parregullt, qendrat ku mbahen shtetasit e huaj të privuar nga liria dhe azilkërkesit, si dhe institucionet psikiatrike dhe shtëpitë e të moshuarve.

Qëllimi i inspektimit ishte vlerësimi i përgjithshëm i respektimit të të drejtave themelore të të arrestuarve, të ndaluarve dhe të shoqëruarve, të cilat ju garantohen me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe me standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të personave të privuar nga liria.

Gjithashtu, u verifikuan procedurat që ndjekin punonjësit e policisë në zbatim të Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 për miratimin e procedurës standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, si dhe Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019 për miratimin e procedurës standarde të punës “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”.

Institucioni i Avokati i Popullit, pasi u njoh me konstatimet e grupit inspektues të MKPT-së dhe nivelin e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga inspektimi i mëparshëm, ka detyrimin kushtetues dhe ligjor t’ju parashtojë konkluzionet përfundimtare, të referuara si më poshtë vijon:

### **Shënime të përgjithshme**

Në përputhje me metodologjinë e inspektimit të MKPT-së, grupi i inspektimit u takua me drejtorin e DVP Dibër z. Dhimitraq Ziu dhe me shefin e komanduar të komisariatit z. Alfred Hoxha të cilët u vunë në dijeni lidhur me qëllimin e vizitës së inspektimit të MKPT-së në mjediset ku mbahen personat e privuar nga liria në DVP Dibër.

Në takim, grupi i inspektimit të MKPT-së u informua mbi masat e marra nga strukturat përgjegjëse në DVP Dibër për zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga inspektimi i mëparshëm dhe për ndërtimin e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, si dhe për krijimin e dhomave të sigurisë në këtë institucion, sipas standardeve kombëtare dhe atyre ndërkombëtare për persona të ndaluar/arrestuar.

Në vijim të këtij informacioni, përfaqësuesit e Avokatit të Popullit inspektuan nga afër punimet e ndërtimit të godinës së re me 3 kate të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër. Punimet në godinë kanë përfunduar dhe godina është në fazën e mobilimit të ambienteve të zyrave të administratës së institucionit, të zyrave të pritjes së qytetarëve dhe dhomave të arrestimit/ndalimit. Struktura ishte ndërtuar sipas kërkesave të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, dhe aktit të procedurave standarde “*Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin nr.925, datë 18.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Dhomat e ndalim/arrestimit ishin të ndara më vete për

të rritur, femra dhe të mitur. Ndërkohë, u konstatua se ishin në proces të vendosjes së shtretërve në dhomat e sigurisë, ku ishin ndërtuar 7 dhoma sigurie, nga të cilat 5 dhoma për të rritur, 1 dhomë për gra dhe 1 dhomë për të mitur në konflikt me ligjin. Dhomat e sigurisë ishin ndërtuar brenda standardeve bashkëkohore dhe përcaktimeve të bëra në aktet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe në aktet ndërkombëtare. Kapaciteti i ambienteve ishte për 14 persona të ndaluar/të arrestuar, të ndarë sipas dhomave.

Gjithashtu, bazuar në projektin e miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit në favor të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, punimet ishin në proces e sipër, nisur prej vitit 2021 dhe është parashikuar të përfundojnë për një periudhë prej 24 muajsh, ku godina mendohet të jetë funksionale në tetor të vitit 2023. Vlera e ndërtimit të godinës është në shumën 348.860.996 lekë.

Institucioni i Avokatit të Popullit vlerëson pozitivisht faktin e përfundimit të punimeve dhe fillimin e punimeve për instalimin e sistemit ngrohje/ftohje, të vendosjes së sistemit të monitorimit të kamerave, të shtretërve dhe pajisjeve të tjera sipas fazës së zbatimit të projektit për ndërtimin e godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, duke i inkurajuar për përfundimin e punimeve sa më shpejt në këtë institucion, por duke patur në vëmendje se ajo do të garantojë kushtet, liritë dhe të drejtave e personave gjatë ndalimit/arrestimit në mjediset policore ose në vende të tjera, sipas kushteve dhe rasteve të përcaktuara në ligj. Por nga ana tjetër, Avokati i Popullit kërkon që ndërtimi i institucionit të jetë në zbatim të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, për të respektuar procedurat e shoqërimit të personave në konflikt me ligjin, sipas aktit të procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

Gjithashtu, grupi i inspektimit vizitoi edhe zyrat e specialistëve dhe të ndihmës specialistëve të policisë, që kryejnë veprime procedurale me personat e shoqëruar, si dhe kontrolloi e administroi dokumentacionin përkatës, ku pasqyrohen veprimet e kryera me këta persona. Gjatë ushtrimit të detyrës për inspektimin e ambienteve ku mbahen dhe trajtohen personat e privuar nga liria, grupi inspektues ishte i shoqëruar nga shefi i rendit të Komisarariatit të Policisë Dibër dhe punonjësit e policisë që kryejnë shërbimin në këto ambiente.

Në vijim të inspektimit, u konstatua se dhomat e sigurisë ekzistuese në Drejtorinë Vendore të Policisë Dibër, nuk respektonin standardin e kubaturës dhe sipërfaqes jetike për person të përcaktuar në aktet normative. Ndërkohë që mungesa e shtretërve dhe pajisjeve të tjera përbëjnë një trajtim çnjerëzor dhe denigrues për persona të ndaluar/arrestuar, që qëndrojnë në këto ambiente të privimit të lirisë.

Grupi i inspektimit evidentoi gjithashtu se nga verifikimi i zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në inspektimin e mëparshëm, në gjendjen që ndodhen dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, rezultoi se:

- 11. Ishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e një regjistri të veçantë për evidentimin e të dhënave të të miturve të shoqëruar në mjediset e komisarariatit<sup>10</sup>.

---

<sup>10</sup> Kthim pergjigje të shkresës tonë me numër 52 prot, datë 10.01.2023 të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër.

Gjthashtu, u evidentua se **nuk** ishin zbatuar rekomandimet në lidhje me:

12. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për të përfunduar sa më parë ndërtimin e godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe Komisarariatit të Policisë Dibër (Kontratë e cila sipas afateve kohore duhet të përfundojë punimet për një periudhë 24 mujore).
13. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e dhomave të sigurisë me shtretër për fjetjen e personave të arrestuar/ndaluar, sipas kapacitetit fizik të dhomave.
14. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër, për marrjen e masave për përshtatjen e ambientit, sipas kritereve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të ndara me vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin.
15. **Nuk ishte zbatuar rekomandimi**, për zëvendësimin e menjëhershëm të materialeve të fjetjes të vjetëruara si dyshekë, batanije, jastëkë, me materiale të reja.
16. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për pajisjen me telefon fiks, për punonjësit e policisë, i cili të shërbente për njoftimin e zyrës së informacionit në rastet emergjente dhe pajisjen me buton zile/sinjali të montuar në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë.
17. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për lyrjen me bojë dhe dezinfektimin e pjesshëm të mureve të brendshme, të dhomave që ndodhen në ambientin e sigurisë.
18. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për zgjerimin e përmasave të dritareve të dhomave së sigurisë, sipas parametrave teknik dhe të sigurisë, pasi ato janë shumë të vogla dhe nuk lejojnë ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral.
19. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për plotësimin e organikës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmësmjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar.
20. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e dhomës (zyrës) për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, të arrestuar në flagrancë apo të dyshuar për vepra penale, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë, të cilat duhet të jenë të pajisura dhe me sistemin e monitorimit me kamerave audio-video.
21. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për krijimin e ambientit të hapur të ajrimit për personat e arrestuar/ndaluar, në godinën e re të sigurisë të DVP Dibër, por dhe në Komisariatin e Policisë Dibër, sipas parashikimeve në procedurën standarde për këtë qëllim.



22. **Nuk kishte zbatuar rekomandimi**, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e sigurisë, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.

Në lidhje me rekomandimet e Institucionit të Avokatit të Popullit, drejtuesit e institucionit na informuan se ata ndodhen në këto kushte, duke qenë se së shpejti do të jetë në funksion godina e re e Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër sipas akteve ligjore në fuqi. Gjithshtu, na informuan se ka patur komunikim të vazhdueshëm me firmën zbatuese të ndërtimit të godinës dhe sipas tyre brenda muajit qershor të vitit 2023 mund të jetë funksionale sipas standardeve të përcaktuara në ligjin nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar; Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre” si dhe Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019, për miratimin e procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

### **Ambientet e shoqërimit dhe kushtet e tyre**

Në Komisariatin e Policisë Dibër, nuk kishte ambiente të dhomave të shoqërimit sipas kërkesave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit” dhe procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019.

Për mbajtjen e personave të shoqëruar në ambientet e policisë krijohen kushte të nevojshme të përshtatshme të ndryshme nga ato të dhomave të sigurisë, ku garantohet siguria dhe trajtimi njerëzor i tyre, ndërkohë në aktet e lartpërmendura në lidhje me kushtet e mbajtjes dhe sigurinë e personave të shoqëruar, theksohet se “*Mjedisi/ambienti duhet të jetë me sipërfaqe dhe hapësira të bollshme për qëndrim.....si dhe dhoma të ndara më vete për femrat, meshkujt madhorë dhe të miturit*”<sup>11</sup>.

Për personat e shoqëruar në konflikt me ligjin përdorej ambienti i pritjes në hyrje të këtij komisarati ose personat qëndronin në një ambient të hapur me stola në oborrin e jashtëm të institucionit, në mungesë të dhomave të përshtatshme.

Mungesa e dhomave të shoqërimit për personat në konflikt me ligjin, siç është parashikuar në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin nr. 938, dt. 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, tregon mos garantimin e lirive të të drejtave të njeriut, sipas standardeve që kanë të bëjnë me shoqërimit, mbajtjen dhe trajtimin e personave në mjediset e policisë.

Në momentin e inspektimit nuk kishte asnjë person të shoqëruar, dhe për rrjedhojë nuk u realizuan intervistime lidhur me trajtimin që u bëhet këtyre personave nga ana e punonjësve të policisë. Ndërkohë nga regjistri i të shoqëruarve, për periudhën Janar – Shtator 2023, rezultoi se ishin shoqëruar për në mjediset e komisarariatit 65 persona, nga të cilët 1 person i mitur në konflikt me ligjin. Sipas verifikimit të regjistrit të shoqërimit nuk kishte të shoqëruara gra për vitin 2023 në institucionin e privimit të lirisë.

---

<sup>11</sup> Kreu VI, pika 3 të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit”.

Marrja në pyetje dhe intervistimi i të shoqëruarve, vazhdon të kryhej në zyrat e punonjësve të policisë, në mungesë të një dhome të veçantë që të jetë e monitoruar me sistemin e kamerave audio-vizive, e cila do të parandalonte kryerjen e veprimeve të kundraligjshme me të shoqëruarit, si dhe të çdo kundërveprimi të këtyre personave ndaj punonjësve të policisë.

Në mungesë të intervistave me personat e shoqëruar, nga informacioni i punonjësve të policisë së komisariatit, grupi i inspektimit evidentoi se personave të shoqëruar ju jepej karta e të drejtave që në momentin e hyrjes së tyre në komisariat.

Gjatë inspektimit, në ambientet e komisariatit, nuk u konstatuan sende dhe mjete të tilla që mund të shërbenin për kryerjen e vetëvrasjeve apo për kundërveprim ndaj punonjësve të policisë.

Gjithashtu, u evidentua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109, paragrafi 5<sup>12</sup> dhe nenin 122, paragrafi 5<sup>13</sup> të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në Kapitullin VIII, pika a.3.4<sup>14</sup> të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimit të çështjes përkatëse.

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë në Komisaratin e Policisë Dibër mbaheshin procesverbalet përkatëse, ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

### **Ambientet e sigurisë dhe kushtet e tyre**

Ambienti i sigurisë në Komisaratin e Policisë Dibër, **nuk** ishte i ndërtuar sipas parashikimeve të bëra në procedurën standarde “*Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019 dhe kushtet në të cilat ndodhet ky ambient, bien në kundërshtim të hapur me standardet e përcaktuara në “*Konventën europiane për parandalimin e torturës dhe dënimeve ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese*”<sup>15</sup>.

---

<sup>12</sup> Neni 129, paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar parashikon se: “*Punonjësi i policisë, dokumenton në procesverbal veprimet e kryera me personin e shoqëruar. Procesverbalin nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi i shoqëruar. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit të shoqëruar.*”

<sup>13</sup> Neni 122, paragrafi 5 i Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit” i ndryshuar parashikon se: “*Veprimet e mësipërme për marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të parashikuar në këtë dispozitë, dokumentohen në procesverbal. Procesverbalin nënshkruhet në fund të çdo flete nga punonjësi i policisë që ka kryer veprimet dhe personi/at që kanë qenë të pranishëm gjatë kryerjes së këtyre veprimeve. Një kopje e procesverbalit i vihet në dispozicion personit, ndaj të cilit janë marrë masat mbrojtëse, ose familjarit/kujdestarit të tij.*”

<sup>14</sup> Urdhër nr. 938, datë 24.07.2019 procedura standarde e punës për “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”: Procesverbalin i veprimeve të kryera me personin e shoqëruar: a.3.4 “*Procesverbalin hartohet në dy kopje, një kopje e procesverbalit i jepet detyrimisht personit të shoqëruar dhe kopja tjetër dorëzohet në sekretari/arshivën e njësisë policore.*”

<sup>15</sup> <https://rm.coe.int/16806dbac6>

Ambienti i sigurisë ndodhej në katin e parë të godinës së komisarariatit, ku ndodheshin 3 dhoma sigurie, të cilat ishin funksionale, por ato ishin jashtë kushteve teknike dhe kritereve për mbajtjen, sigurimin dhe trajtimin e personave të arrestuar/ndaluar.

Dhomat e sigurisë ishin të ndara në 2 dhoma për personat e arrestuar/ndaluar të rritur dhe 1 dhomë për të miturit. Kapaciteti fizik ishte për mbajtjen dhe sigurimin e 6 personave të arrestuar/ndaluar. Përmasat e dhomave ishin 3x2m dhe nuk plotësonin normat dhe parametrat teknike jetësore, të hapësirës dhe sipërfaqes për një person të arrestuar/ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte më pak se 10 metra<sup>2</sup> dhe nuk ishte e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m<sup>2</sup> dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m<sup>2</sup><sup>16</sup>.

Gjithashtu, DVP-Dibër kishte një dhomë të sigurisë që ndodhej në Spitalin Rajonal Dibër, e cila shërbente për mbajtjen dhe akomodimin e të ndaluar/arrestuarve femra. Ajo ishte me hapësirë dhe sipërfaqe të bollshme për jetesë normale me përmasa 4x4 m<sup>2</sup> dhe kishte kapacitet për 1 (një) person.

Dritaret e dhomave ishin të vogla dhe **nuk** mundësonin futjen e sasisë së mjaftueshme të ajrit dhe dritës natyrale. Ndërsa ndriçimi artificial sigurohej nga rrjeti elektrik dhe një gjenerator për rastet kur kishte ndërprerje të energjisë elektrike.

Dhomat e sigurisë **nuk** ishin të plotësuara me shtretër për fjetjen e personave të ndaluar/arrestuar, ndaj në këto kushte këta persona flinin me dyshekë që vendoseshin në dyshemënë prej dërrase. Dhomat ishin të pajisura me materialet e fjetjes, si dyshekë e batanije, por ato ishin të vjetëruara dhe të dëmtuara.

Në ambientin e sigurisë, lagështira vazhdonte të ishte prezente kudo dhe muret e brendshme të dhomave ishin të amortizuara. Në rastet kur binte shi, tavani i dhomave pikonte dhe kishte krijuar shenja myku në mure, duke e bërë të pamundur qëndrimin dhe trajtimin dinjitoz të personave të arrestuar/ndaluar, që sigurohen në këto dhoma.

Në korridorin e ambientit të sigurisë, ndodhej një ambient i përbashkët që shërbente si tualet dhe për larjen e trupit. Ambienti ishte i plotësuar me nyje hidrosanitare, ndërsa për larjen e trupit kishte ambient të posaçëm (dushe me ujë të ngrohtë).

Ambienti i sigurisë **nuk** kishte të instaluar sistemin ngrohje/ftohje me kaldajë qendrore, sikurse parashikohet në pikën 3/c, Kreu VIII të procedurës standarde. Për shkak të kushteve të rënduara atmosferike në periudhën e dimrit në këtë zonë, ngrohja sigurohej me pajisje elektrike të siguruara nga vetë institucioni, të cilat administroheshin nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë.

Në korridorin e ambientit të sigurisë **nuk** kishte aparat telefonik fiks apo citofon për t'u përdoruar nga punonjësit e shërbimit në rastet e tentativave apo ngjarjeve të rënda me të ndaluarit/arrestuarit, për të kërkuar ndihmë dhe ndërhyrje të shpejtë. Po ashtu, në dhomat e sigurisë mungonte butoni me zile për njoftimin e personelit të shërbimit, në rastet e nevojave nga personat e ndaluar/arrestuar.

Në ambientin e sigurisë kishte një dhomë të përbashkët që përdorej si zyrë pune nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë, por edhe si dhomë për takimin e të ndaluarve/arrestuarve me avokatët mbrojtës dhe marrjen e tyre në pyetje nga oficerët e policisë gjyqësore. Kjo

---

<sup>16</sup> Kreu VIII, pika 3/3.3 e procedurës standarde "Trajtimi dhe Sigurimi i Personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre".

dhomë ishte e pajisur me tavolinë pune dhe karrige për qëndrimin ulur, por **nuk** ishte e monitoruar me sistemin e kamerave. Nisur nga funksioni që kanë këto ambiente, ato duhet të jenë të ndara secila dhomë më vete dhe duhet të jenë të monitoruara me kamera.

Ndërkohë, hyrjet në dhomat e sigurisë dhe korridori i dhomave të sigurisë monitoroheshin nga sistemi i kamerave.

Në ambientin e sigurisë ndodhej edhe dhoma e mjekut për kryerjen e vizitave mjekësore, e cila ishte e pajisur me krevat, tavolinë dhe karrige, por dhe ajo **nuk** përmbushte standardet e parashikuara, pasi ishte e pa ndriçuar mirë, e ftohtë dhe e papërshtatshme për kryerjen e vizitave mjekësore.

Ndërkohë, nuk kishte hapësira për ajrimin e personave gjatë qëndrimit në dhomat e sigurisë.

Për marrjen në pyetje të të miturve ishte krijuar “Njësia për intervistimin e të miturve”, në kuadër të projektit 2019-2021 të financuar nga DPPSH, Qeveria e Mbretërisë së Bashkuar dhe UNICEF për ndërtimin e këtyre ambienteve në disa nga Drejtoritë/Komisariatet e Policisë së Shtetit. Ky ambient përbëhej nga 3 dhoma të pajisura me mjetet dhe orenditë e punës për specialistët e policisë të trajnuar për këtë qëllim, për psikologun, si dhe për qëndrimin ulur dhe komod të fëmijës dhe të prindit (kujdestarit ligjor), sikurse përcaktohet në Kodin e Drejtësisë Penale për të Miturit dhe në procedurën standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar”. Pamjet filmike të kamerave që monitorojnë ambientin ku merren në pyetje të miturit, ruhen deri në 30 ditë në një server që administrohej nga DVP Dibër.

Në momentin e inspektimit, në dhomat e sigurisë ndodhej një person i ndaluar/arrestuar, i cili sapo ishte vendosur në dhomat e sigurisë. Për periudhën e inspektimit Janar – Shtator 2023 në dhomat e sigurisë së këtij komisariati, janë trajtuar dhe siguruar 37 persona të arrestuar/ndaluar dhe asnjë prej tyre nuk ishte femër dhe i mitur. Sipas shënimeve në regjistër, nuk rezultoi të kishte mbipopullime në dhomat e sigurisë, në asnjë periudhë kohore.

Nga informacioni i drejtuesve të komisariatit dhe punonjësve të policisë që shërbenin në dhomat e sigurisë, personat e ndaluar/arrestuar trajtoheshin me ushqim 3 (tre) herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në Vendimin Nr.189, datë 15.03.2017 “Për trajtimin me ushqim të punonjësve, të studentëve dhe të kursantëve në institucionet arsimore të Policisë së Shtetit, si dhe të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar deri në sqarimin e pozitës së tyre”. Ushqimi gatuhej në mensën që ndodhej brenda territorit të komisariatit dhe shërbehej sipas vakteve nga kuzhinerët dhe punonjësit e policisë.

Ndonëse në ambientet e sigurisë nuk kishte ambiente kulti, të ndaluarve/arrestuarve që dëshironin u lejohej ushtrimi i riteve fetare brenda dhomave të sigurisë. Nga informacioni i përgjegjësit të dhomave të sigurisë, personave të ndaluar/arrestuar u jepen produkte për ruajtjen e higjienës vetjake dhe të ambientit, si sapun, detergjentë, letra higjienike dhe letra për fshirjen e duarve dhe të fytyrës.

Nga informacionet e grumbulluara gjatë vizitës inspektuese nuk rezultoi ndonjë rast i përdorimit të mjeteve të forcës dhe shtrëngimit fizik, si dhe asnjë rast i përdorimit të

armëve të zjarrit nga ana e policisë, ndaj shtetasve të ndaluar/arrestuar me qëllim përmbushjen e një synimi të ligjshëm sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Për sa më sipër, Avokati i Popullit në mënyrë të përsëritur vëren se kushtet në të cilat ndodhen dhomat e mbetura hapur në Komisaratin e Policisë Dibër, nuk plotësojnë kushtet për të konsideruar mbajtjen e të burgosurve në to dhe konsiderohet si një trajtim degradues. Gjithashtu, mbajtja e një numri dhomash nuk e ka përmirësuar gjendjen në të cilën trajtohen të arrestuarit në këtë komisarati.

### **Regjistri i personave të shoqëruar, ndaluar/arrestuar dhe evidentimi i tyre**

Në Komisaratin e Policisë Dibër “Regjistri i evidentimit të të dhënave për personat e shoqëruar” ishte i tipit “Model nr.1” sipas procedurës standarde “*Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e Policisë së Shtetit*”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.938, datë 24.07.2019. Regjistri ishte i plotësuar sipas rubrikave dhe ishte i sekretuar.

Të gjithë personat e shoqëruar në organin e policisë sipas dispozitave të ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, regjistroheshin në këtë regjistër nga punonjësit e zyrës së informacionit. Nga këqyrja e këtij regjistri rezultoi se të gjitha rubrikat e tij ishin plotësuar me përgjegjësi nga punonjësit e zyrës së informacionit. Koha e qëndrimit në gjendje shoqërimi ishte e ndryshme nga 1 orë deri në 10 orë, në raste të veçanta.

Ndërsa të ndaluarit/arrestuarit që trajtoheshin e siguroheshin në ambientet e sigurisë në këtë Komisarati evidentoheshin në “*Regjistrin e të dhënave të personave të ndaluar/arrestuar*”, i cili ishte i sekretuar. Edhe ky regjistër ishte i plotësuar me korrektësi në të gjitha rubrikat e tij nga përgjegjësi i dhomave të sigurisë së komisarariatit.

Nga këqyrja e këtyre regjistrave rezultoi se, në rastet e arrestimeve dhe të ndalimeve të personave të shoqëruar, ora e arrestimit/ndalimit përputhej me orën e momentit të shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë. Kjo situatë, u verifikua edhe për personat e ndaluar apo të arrestuar nga Komisarati i Policisë së Bulqizës, të cilët në përfundim të procedurave ligjore të kryera nga specialistët e krimeve, dërgoheshin në dhomat e sigurisë së Komisarariatit të Policisë Dibër.

Avokati i Popullit ka rekomanduar se, në rastet kur për personat e shoqëruar në organet e policisë vendoset arrestimi apo ndalimi, në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, duhet të vendoset ora e futjes në mbikqyrje policore dhe jo ora e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo ora kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.

Përsa më sipër, bazuar në aktet kombëtare dhe ato ndërkombëtare, nëse një person arrestohet në flagrancë apo ndalohet, në procesverbalin përkatës të arrestimit/ndalimit duhet të vihet çasti (ora e kapjes së tij në fakt), kur ai është privuar realisht nga liria. Pra, sapo ai kapet dhe prangoset nga punonjësi i policisë që ka bërë kapjen në flagrancë apo ora kur bëhet ekzekutimi i urdhrin të ndalimit. Duke iu referuar neneve 144, 250 të Kodit të Procedurës Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose i ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të Kodit të Procedurës Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilit prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Rekomandimet e Avokatit të Popullit janë bazuar jo vetëm në parimet universale të së drejtës dhe në parimet e përgjithshme të së drejtës tonë penale, por edhe në dispozitat ligjore të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, respektivisht nenet 144, 250 dhe 259 të tij, si dhe nenin 109, pika 4 të ligjit 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar.

Nga inspektimi u evidentua se, komisariati kishte regjistër të veçantë për të miturit të shoqëruar dhe arrestuar/ndaluar në konflikt me ligjin, ku të evidentohen të gjithë rastet e të miturve të shoqëruar në këto ambiente.

Grupi i inspektimit, konstatoi se në dhomat e sigurisë të komisariatit kishte regjistër për evidentimin e kërkesë/ankesave të personave të shoqëruar, të arrestuar dhe të ndaluar, sikurse parashikohet në nenin 115 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, por për periudhën që kryhej inspektimi, nuk ishte evidentuar asnjë kërkesë apo ankesë.

Në Komisaratin e Policisë Dibër u konstatua gjithashtu se kishte edhe regjistër për takimet me avokatin mbrojtës dhe prokurorin, regjistër të vizitave mjekësore, regjistër të shoqërimit të personave në ndaluar në gjykatë apo në institucione të tjera, si dhe regjistër të marrjes në pyetje nga prokurorët e çështjes.

### **Ambientet e intervistimit**

Në Komisaratin e Policisë Dibër, punonjësit e policisë gjyqësore i kryenin intervistat dhe marrjen në pyetje të personave të shoqëruar në zyrat e punës së tyre, për shkak të mungesës së ambienteve të veçanta për marrjen në pyetje/intervistimin e shtetasve të shoqëruar. Ndërsa në ambientin e sigurisë, si dhomë për marrjen në pyetje të personave të ndaluar/arrestuar, shërbente zyra e përgjegjësit të dhomave të sigurisë, pra nuk ishte një ambient më vete. Këto zyra nuk ishin të monitoruara me sistemin e kamerave audio-vizive, duke përbërë një standard tjetër të munguar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, duke iu referuar standardeve ndërkombëtare, e konsideron procesin e monitorimit filmik një element parësor për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut, pasi ka efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve/ arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e Policisë së Shtetit<sup>17</sup>.

Grupi i inspektimit, konstatoi dhe një problematikë tjetër që kishte të bënte me kohën e vënies në dispozicion të kartës me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar apo ndaluar në mjediset e policisë. Aktualisht, personat e shoqëruar/ndaluar nënshkruajnë një deklaratë që vërteton se morën një kopje të fletës me të drejtat e tyre, në përfundim të procesit të marrjes në pyetje në organin e policisë. Por, CPT i ka rekomanduar institucioneve përgjegjëse të Policisë së Shtetit gjatë inspektimit të kryer në vitin 2018-të, se personat e shoqëruar/ndaluar duhet të jenë plotësisht të informuar për të drejtat e tyre që nga fillimi i privimit të lirisë (momenti i shoqërimit), duke siguruar informacione të qarta verbale rreth të drejtave ligjore/procedurale që ata kanë që në fillim të privimit të

---

<sup>17</sup> “Një sistem i monitorimit të vazhdueshëm i standardeve dhe procedurave të intervistave të policisë duhet vënë në zbatim. Po ashtu, kjo kërkon një regjistrim të saktë të intervistave të personave në ambientet e policisë, të cilat, nëse është e mundur duhet të zhvillohen me pajisje regjistruese elektronike (audio dhe/video). Duhet të kërkohet që të regjistrohet në mënyrë sistematike koha kur ka filluar dhe mbaruar intervista, ndonjë kërkesë e bërë nga i ndaluari gjatë intervistës, si dhe nga personat e pranishëm gjatë çdo interviste.” Raporti i CPT-së për Armeninë: CPT/Inf (2016) 31 [par.20]

lirisë<sup>18</sup>. Sipas gjetjeve të inspektimit edhe të MKPT, karta me të drejtat e personave të ndaluar u jepej atyre në fund të procesit të marrjes në pyetje dhe jo që në momentin e shoqërimit për në mjediset e komisariatit. Karta e të drejtave ka për qëllim për të njohur të shoqëruarit dhe të arrestuarit me të drejtat e tyre para zhvillimit të procedurave në ambientet e komisariatit.

Gjithashtu në ambientet e godinës të komisariatit ishte krijuar një ambient i veçantë (magazinë) për administrimin dhe ruajtjen e provave materiale, në interes të hetimit që zhvillonte organi i prokurorisë.

### **Ndihma juridike, psikologjike dhe kujdesi mjekësor**

Në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të Ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të procedurave standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse.

Gjatë inspektimit, u konstatua se detyrimi ligjor për të njoftuar personat e ndaluar/arrestuar madhor që në mungesë të mundësive financiare për të pajtuar një avokat privat, kërkon ndihmë juridike, atij u ofrohej një avokat kryesisht dhe iu ishte krijuar mundësia për të kontaktuar me të<sup>19</sup>.

Avokatët siguroheshin nga lista e avokatëve të dërguar nga organi i prokurorisë, e cila ishte e afishuar në zyrën e përgjegjës të zyrës së informacionit.

Në rastet kur të ndaluarit/arrestuarit ishin të mitur, veprimet procedurale kryheshin në praninë e detyrueshme të avokatit mbrojtës të caktuar kryesisht dhe të psikologut që ofrohej menjëherë nga Drejtoria Vendore e Policisë Dibër.

Në Komisaratin e Policisë Dibër nuk kishte ndonjë zyrë të monitoruar me kamera për marrjen në pyetje të shtetasve të shoqëruar dhe ndaluar/arrestuar nga punonjësit e policisë.

Gjatë inspektimit u konstatua se në korridoret e godinës, si dhe në dhomën që përdorej për shoqërim në këtë komisariat ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar.

Ndërkohë u konstatua se në këtë komisariat zbatohet detyrimi ligjor i parashikuar në nenin 109/5 dhe 122/5 të ligjit nr. 108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, si dhe në kapitullin VII, pika a.3.4 të Procedurave Standarde për plotësimin dhe dhënien e procesverbalit të veprimeve të kryera me të shoqëruarit nga punonjësit e policisë që ishin ngarkuar me detyrën e kryerjes së verifikimit dhe trajtimin e çështjes përkatëse. Rezultoi se ndaj personave të shoqëruar nga punonjësi i policisë mbahej një procesverbal tip i emërtuar “Formulari i raportit të Shoqërimit ose Ndalimit/Arrestimit”.

<sup>18</sup> Komiteti Europian për Parandalimin e Torturës ju ka rekomanduar CPT/Inf (2019) 28<sup>18</sup>.

<sup>19</sup>CPT ka rekomanduar se duhet të bëhen përpjekje të mëtijshme për të siguruar që e drejta për t'u informuar për ndalimin/arrestimin të garantohet në praktikë që nga fillimi i heqjes së lirisë. Sipas nenit 255/4 të Kodit Penal, policia informon familjen e personit të ndaluar/arrestuar pa vonesë. CPT ka rekomanduar që oficerët e policisë duhet të kenë parasysh që të lejojnë të ndaluarit/ arrestuarit të kenë qasje tek një avokat (e drejta për të pasur një avokat privat, të flasin me të dhe të jenë të pranishëm gjatë marrjes në pyetje) që nga fillimi i heqjes së lirisë dhe të garantojnë në praktikë këtë e drejtë. Raporti CPT-së për Shqipërinë CPT/Inf (2019).

U evidentuan disa praktika të njëpasnjëshme, ku në përfundim të procedurave dhe veprimeve të kryera nga punonjësit e policisë, mbaheshin procesverbalet përkatëse ku një kopje e të cilit firmosej dhe i jepej personit të shoqëruar.

Gjatë inspektimit u konstatua se, në korridoret e godinës së këtij komisarati ishin afishuar postera me të drejtat ligjore të personave të shoqëruar në organin e policisë dhe të personave të ndaluar/arrestuar, por ato duhen të vendosen dhe brenda në dhomat e shoqërimit dhe të sigurisë, si dhe në vende që të jenë të aksesueshme nga të ndaluarit dhe të shoqëruarit në mjediset e policisë. Gjithashtu, për shtetasit e ndaluar/arrestuar me shtetësi të huaj ishin përgatitur postera me të drejtat e të ndalurve/arrestuarve në 9-të gjuhë të huaja, si anglisht, frëngjisht, italisht, greqisht, gjermanisht, maqedonisht, serbisht, sllovenisht dhe rome.

Grupi i inspektimit konstatoi se, vizitat mjekësore në mungesë të mjekut në organikë të DVP Dibër, kryheshin nga mjekët e Spitalit Rajonal Dibër brenda afatit 12 orë, nga momenti i vendosjes së këtyre personave në ambientin e sigurisë, sikurse përcaktohet në Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr. 925, datë 18.07.2019, për miratimin e procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*<sup>20</sup>.

Vizitat mjekësore ndaj të ndaluarve/arrestuarve, konstatimet, rekomandimet dhe mjekimet e dhëna pasqyroheshin në regjistrin e vizitave mjekësore. Gjithashtu, për secilin person hapeshin edhe kartelat mjekësore (kartelat ditore) të tyre, të cilat vendoseshin në fashikullin përkatës për çdo të ndaluar/arrestuar.

Mungesa e mjekut apo ndihmës mjekut me kohë të plotë në bazë të strukturës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër, çënon standardin për trajtim mjekësor me dinjitet të personave të arrestuar/ndaluar, për kohën që qëndrojnë në dhomat e sigurisë së Drejtorisë/Komisariateve në varësi të saj. Të dhënat e paraqitura më lart, nuk u verifikuan nga persona të ndaluar apo të shoqëruar, pasi nuk kishte persona në këtë cilësi në Komisaratin e Policisë Dibër.

Për sa më sipër dhe në mbështetje të pikës 3, të nenit, 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga administrata publike”*; të nenit 21, germa “b” të ligjit nr. 8454 dt. 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, ku thuhet se: *“Avokati i Popullit paraqet rekomandime për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ, që, sipas tij ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive; si dhe në bazë të nenit 81, pika 2/b të ligjit Nr. 81/2020 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, ku parashikohet midis të tjerash se: “Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës ka këto kompetenca: b) paraqet rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerëzor ose poshtërues”*:

## **REKOMANDOJMË:**

---

<sup>20</sup> Kreu V, pika 7.2 të procedurës standarde *“Trajtimi dhe sigurimi i personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”*.



2. Marrjen e masave të menjëhershme, për të përfunduar sa më parë ndërtimin e godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër dhe Komisarariatit të Policisë Dibër (Kontratë e cila sipas afateve kohore duhet të përfundojë punimet për një periudhë 24 mujore). Avokati i Popullit rekomandon se duhet të sigurohet që projekti i ri, në përfundim do të garantojë tërësisht kërkesat e ligjit nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, aktit të procedurës standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në polici”, miratuar me Urdhrin Nr.938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, si dhe procedurës standarde “Për trajtimin dhe sigurimin e personave të arrestuar/ndaluar në ambientet e Policisë së Shtetit, evidentimi dhe zgjidhja e kërkesë/ankesave të tyre”, miratuar me Urdhrin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.925, datë 18.07.2019.

**Deri në përfundimin e punime dhe vënien në funksion të godinës së re të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër rekomandojmë:**

11. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e dhomave të sigurisë me shtretër për fjetjen e personave të arrestuar/ndaluar, sipas kapacitetit fizik të dhomave.
12. Marrjen e masave menjëhershme, për përshtatjen e një ambienti, sipas kriterëve të parashikuara në Kreun VII, pika 4 të procedurave standarde “Rregullat teknike të shoqërimit në mjediset e policisë së shtetit”, miratuar me Urdhrin nr. 938, datë 24.07.2019 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit, për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të ndara me vete për persona të rritur, femra dhe të mitur në konflikt me ligjin.
13. Marrjen e masave të nevojshme, për pajisjen me telefon fiks, për punonjësit e policisë, i cili të shërbente për njoftimin e zyrës së informacionit në rastet emergjente dhe pajisjen me buton zile/sinjali të montuar në mur për kontaktin e personave të arrestuar/ndaluar me punonjësin e policisë në rast nevojë.
14. Marrjen e masave, për zëvendësimin e menjëhershëm të materialeve të fjetjes të vjetëruara si dyshekë, batanije, jastëkë, me materiale të reja.
15. Marrjen e masave të nevojshme, për lyrjen me bojë dhe dezinfektimin e pjesshëm të mureve të brendshme, të dhomave që ndodhen në ambientin e sigurisë.
16. Marrjen e masave të menjëhershme, për zgjerimin e përmasave të dritareve të dhomave së sigurisë, sipas parametrave teknik dhe të sigurisë, pasi ato janë shumë të vogla dhe nuk lejojnë ajrimin dhe ndriçimin e plotë natyral.
17. Marrjen e masave të menjëhershme, për plotësimin e organikës të Drejtorisë Vendore të Policisë Dibër me mjek/ndihmës mjek me kohë të plotë, për kryerjen e vizitave mjekësore të personave të ndaluar/arrestuar.
18. Marrjen e masave të nevojshme, për krijimin e dhomës (zyrës) për marrjen në pyetje personat e ndaluar/arrestuar nga oficerët e policisë gjyqësore, të arrestuar në

flagrancë apo të dyshuar për vepra penale, para se ata të dërgohen në ambientet e sigurisë, e cila të jetë e pajisur dhe me sistemin e monitorimit me kamerave audio-video.

19. Marrjen e masave për krijimin e një ambienti të hapur të ajrimit për personat e arrestuar/të ndaluar, në godinën e re të sigurisë të DVP Dibër, por dhe në Komisarjatin e Policisë Dibër, sipas parashikimeve në procedurën standarde për këtë qëllim.
20. Marrjen e masave të menjëhershme, për sigurimin e sistemit të ngrohjes ose vendosjen e pajisjeve elektrike në dhomat e sigurisë, për ngrohjen e këtyre ambienteve kryesisht në periudhën e dimrit.
21. Marrjen e masave të menjëhershme, për vendosjen e orës së mbikëqyrjes policore në procesverbalin e arrestimit në flagrancë ose të ndalimit, për personat e shoqëruar në organet e policisë dhe jo orën e shoqërimit të tyre për në mjediset e policisë apo orën kur përpilohet procesverbali i arrestimit/ndalimit.
22. Marrjen e masave të nevojshme nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, për analizimin e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit në kompetencë të këtij institucioni, si dhe nxjerrjen e përgjegjësive për dhënien e masave disiplinore ndaj personave përgjegjës.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij rekomandimi, të vihemi në dijeni brenda afatit 30 ditor sipas nenit 22 të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

*Duke besuar në mirëkuptimin dhe bashkëpunimin tuaj,*

**KOMISIONER**

**AHMET PRENÇI**